

GAZMEND SHPUZA

PASHKO VASA DHE LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT

Pashko Vasa me veprimtarinë e tij të dendur e të gjithanshme ka luajtur një rol parësor në zhvillimet e viteve 1878-1881, e cila shpaloset vendimtare që në vitin e parë të ekzistencës së Lidhjes së Prizrenit.

Pashko Vasa u gjend në radhët e para të atdhetarëve të rreshtuar në Komitetin e Stambollit. Si anëtar i tij formuloi i vetëm apo dhe me të tjerë aktet e para për mbrojtjen e të drejtave kombëtare dhe territoriale të popullit shqiptar. Kur krerët kryesorë të të gjithë Shqipërisë ndodheshin në Stamboll, ai u ndodh, jo rastësisht, në Kosovë në themelimin e Lidhjes së Prizrenit.

Pashko Vasa përpunoi në mënyrë krijuese dhe përgjithësoi, në varësi të zhvillimeve vendore dhe ndërkombëtare, mendimin politik shqiptar më të përparuar të atyre momenteve, duke kontribuar në kristalizimin e platformës së Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Që në ditët e para të themelimit të Lidhjes së Prizrenit, ai e bëri atë flamur të lëvizjes popullore.

Konsulli rus në Prizren, Jastrebov, më 2 tetor 1879, i raportonte shefit të tij në Stamboll mbi qëndrimet e synimet politike të kahershme të ish këshilltarit të valiut të Kosovës, Vasa efendiut. Shqiptar i lindur në Shkodër dhe i edukuar në Itali, ky «nuk kishte pushuar kurrë të ëndërronte për një principatë shqiptare të pavarur». «Ai, vijon konsulli rus, i paraqiti qeverisë një projekt për organizimin e lëvizjes shqiptare nën emrin e Lidhjes, duke e fshehur prapamendimin që kjo lëvizje do ta shtronte çështjen shqiptare ».

Duke përgjithësuar përvojën historike të lidhjeve krahinore dhe ndërkrahinore, si dhe të përqendrimit të shqiptarëve të Shqipërisë së Veriut dhe asaj të Jugut nën udhëheqjen e Bushatasve dhe të Ali Tepelenës, Pashko Vasa perceptoi dhe propagandoi idenë e një Lidhjeje të një lloji të ri dhe të një shkalle më të lartë popullore mbarëshqiptare.

Nevojën dhe interesin e përbashkët të një organizate të tillë në kushtet e zhvillimit të Krizës Lindore ai ia parashtrroi, siç na dëshmojnë dokumentet konsullore ruse, dhe Portës së Lartë. Pa pritur miratimin e Stambollit, këshilltari i valiut të Kosovës u vu në ballë të përpjekjeve për sendertimin e saj sa më të shpejtë brenda vendit.

Siç rezultoi, Pashko Vasa ka qenë ndër ideatorët e parë, në mos më i pari, i Lidhjes mbarëshqiptare. Ai kishte skicuar dhe një projekt konkret për organizimin e saj. Këtë projekt ai guxon t'ia parashtrrojë Portës së Lartë, duke bërë apel në interesin e ndërsjellë të Turqisë dhe të Shqipërisë për organizimin e saj. Edhe pse nuk arriti të sigurojë mirëkuptimin e Stambollit dhe angazhimin e tij konkret për realizimin e projektit të tij, Vasa dhe lëvizja popullore që vlonte në vend, mundi të paralizojë për një kohë kundërshtimin e nëpunësve Osmanë në Vilajetin e Kosovës.

Ëndrra e Pashko Vasës për pavarësinë e Shqipërisë, për të cilën bën fjalë diplomati rus, kishte nisur të kristalizohej brenda trojeve shqiptare në kushtet e krijuara pas disfatës së forcave ushtarake osmane në luftën me Rusinë në vitin 1877. Përkujtesa e bashkëqytetarëve shkodranë të Pashko Vasës drejtuar ministrit të punëve të jashtme të Britanisë së Madhe, lordit Bikonsfild më 13 qershor 1878, formulon dhe shtron si detyrë për zgjidhje, në mënyrë programore, platformën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, realizimin e synimit final të saj.

Kuvendi i Prizrenit elektrizoi botën shqiptare, tronditi gjithë zemrat e shqiptarëve dhe çoi në një marrëveshje mbarëpopullore.

Vendimet programore të marra në Kuvendin e Prizrenit vështirë të kuptohen pa praninë dhe pa pjesëmarrjen aktive të Pashko Vasës, në kushtet e mungesës së krerëve të tjerë kryesorë të vendit. Në to Pashko Vasa pasqyron, siç dëshmon konsulli rus në Prizren, sintezën e pikëpamjeve të veta politike të materializuara në këto vendime historike.¹

¹ Krahas veprimtarisë politike dhe organizative të ngjeshur dhe tejet aktive të zhvilluar gjatë vitit 1878, Vasa efendiu gjen kohën të merret dhe me veprimtari kulturore dhe shkencore të mirëfillë. Në këtë vit ai boton frengjisht librin mbi alfabetin latin që duhej të përshtatej për gjuhën shqipe. Pavarësisht nga pikëpamjet vetiake për këtë problem filologjik, i nënshtrohet vendimit të Shoqërisë së shkronjave, anëtar kryesor i së cilës ai ishte, dhe veprën "Shqypnija e shqypart,, e boton me alfabetin e Stambollit. (Pasco Wassa, *L'alphabet latin appliqué à la langue albanaise*, Constantinople, Imprimerie du Corrier d'Orient, 1878).

Pikëpamjet e Pashko Vasës për zgjidhjen politike të çështjes shqiptare në këto momente vendimtare janë mishëruar në dokumentet kryesore të Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit të datës 15 qershor 1878.² Kjo flet bindshëm për rolin parësor të Pashko Vasës në themelimin e Lidhjes Shqiptare dhe orientimin e drejtë të saj në përputhje me interesat kombëtare të momentit dhe të ardhmërisë së mbarë kombit shqiptar.

Përfaqësuesit e organizmave lokale, nga Kosova, të mbledhur në Kuvend formuan Lidhjen Shqiptare dhe më 15 qershor 1878, shpallën gatishmërinë e vendosmërinë e tyre për të mbrojtur të gjithë së bashku pa dallim besimi tërësinë e trojeve shqiptare nga çdo vendim i padrejtë i Kongresit të Berlinit dhe nga çdo agresion ngado që të vinte. Kuvendi, pikë së pari, i bëri të qartë me vendosmëri Portës së Lartë : *“Ne në Lidhjen tonë vendosëm që para së gjithash të provojmë që, pa diskutuar për fenë, jemi shqiptarë”*.

Nuk është vështirë të kuptohet se refreni i manifestit artistik të Lidhjes të shpallur te poezia « O, moj Shqypni » e Vasës: “Feja e shqiptarit asht shqiptaria” ishte përgjithësim artistik i një realiteti, të cilin ai e kishte njohur ato ditë për së afërmi jo vetëm si dëshmitar i drejtë për drejtë, por dhe si protagonist kryesor i zhvillimeve diplomatike, organizative dhe politike në vend. Nuk mund të ketë kurrëfarë dyshimi se ishte këshilltari i valiut ai që kishte bërë të mundur me horizontin e tij kulturor dhe politik, siç do ta shohim dhe më poshtë, që këto ide sa të përparuara aq edhe realiste të përshkonin tej e ndanë dokumentet e para programatike të Lidhjes.

Në dokumentet themeluese të Lidhjes së Prizrenit të datës 15 qershor 1878, me gjithë përfaqësimin, deri më atëherë, tejet të pjesshëm të përfaqësuesve të trevave shqiptare në Kuvend, gjejmë të shprehur qëndrimin largpamës për rrugët e zgjidhjes së drejtë të çështjes kombëtare mbarëshqiptare. Ato ishin pikëpamjet e qarqeve atdhetare të qarta politikisht, të cilat në saj të angazhimit të drejtpërdrejtë të Pashko Vasës u bë e mundur të përçohen mes delegatëve të mbledhur në Prizren.

Një dëshmitar i jehonës së fuqishme të këtyre ngjarjeve, oficeri osman me prejardhje nga Luma, Sylejman Kylçe e kishte plotësisht të qartë edhe pas 66 vjetësh, më 1944, se autoritetet osmane po përballeshin

² Vlen të nënvizohet fakti jo pa rëndësi, që aktet themeluese të Kuvendit të Lidhjes së Prizrenit përfshijnë dhe kërkesën për krijimin e administratës autonome të vilajeteve të bashkuara, janë miratuar në praninë e mytesarifit (prefektit) të Prizrenit, kolegët në mos dhe njërit prej shefave të Vasa efendiut.

“natyrisht (me) një vepër të madhe zgjimi”. Kjo ide madhore programatike nuk mund të sendërtohej pa angazhimin e drejtë për drejtë të një personaliteti si Pashko Vasa.

Detyrën e shpëtimit të viseve shqiptare të rrezikuara nga Traktati i Shën Stefanit organizatorët e Kuvendit të Prizrenit, që në ditët e para të themelimit të Lidhjes Shqiptare, e panë pa kurrfarë diskutimi, të pandarë nga synimi politik për sigurimin e të drejtave kombëtare, qoftë edhe në kuadër të vilajeteve shqiptare të njësuara (Tevhid-i vilayat) me një autonomi sa më të gjerë. Krijimi i Shqipërisë autonome ishte, sipas tyre, zgjidhja më e mirë jo vetëm për të ardhmen e Shqipërisë, por dhe për t’i prerë rrugën rreziqeve të pritshme. Prandaj ata kërkuan: *krijimin e një administrate autonome nën emrin “vilajetet e bashkuara” me qendër Manastirin; caktimin përkohësisht të Gazi Ahmet Muhtar pashës, kryetar të këtyre vilajeteve: angazhimin për krijimin e Këshillave të Lidhjes (që do të punonin) për përhapjen e qëllimeve për pavarësi në qendrat e mëdha, si: Manastiri, Shkupi, Prishtina; mbledhjen e asharit (të dhjetës) dhe të vergjisë (të ardhurat tatimore për nevojat e administratës lokale) në emër të Vilajeteve të bashkuara, duke organizuar (për këtë qëllim) dhe xhandarmërinë si dhe milicinë ushtarake.*

Këtë dokument Sylejman Kylçe e konsideron, jo pa të drejtë, Kushtetuta (anayasa) e Lidhjes. Dhe ajo, në të vërtetë, ishte më tepër se kaq, ishte skicë e projektkushtetutës së Shqipërisë së ardhshme autonome.

Dokumentet programore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, në radhë të parë, “kushtetuta” e “Vilajeteve të njësuara” formulohen, nënshkruhen dhe shpallen në Prizren, kur aty ende nuk kishin arritur përfaqësuesit e vilajeteve të tjera. Madje, dhe kërret më në zë të Kosovës me Omer Prizrenin, Ahmet Koroinicën e të tjerë në krye ishin ende në Stamboll apo rrugës për t’u kthyer në vendet e veta. Pranë tyre ndodhej vetëm Pashko Vasa.

Ndikimin e autoriteteve sulltanore e proislamike në punimet e Kuvendit të Prizrenit, qarqet diplomatike antishqiptare ballkanike dhe evropiane të kohës dhe autorë të ndryshëm me prejardhje nga këto vende përpiqen ta provojnë edhe sot e kësaj dite, duke injoruar vendimet e datës 15 qershor 1878 të këtij Kuvendi. Ata mbyllin sytë përballë projektit të formuluar dhe të shprehur qartë atë ditë për formimin e Shqipërisë autonome. Në të njëjtën kohë, po për këtë qëllim ka autorë të cilët vijojnë të ngulin këmbë në të ashtuquajturin karakter islamik dhe prosulltanor të

dokumentit tjetër të këtij Kuvendi të datës 17 qershor 1878, Kararnamesë.

Përprjekjeve të autoriteteve osmane për ta shpërftytyruar karakterin kombëtar të Lidhjes të sanksionuar në Kuvendin e Prizrenit iu kundërvunë edhe pjesëmarrësit e tij. Ndër ta shquhen, midis afro pesëdhjetë përfaqësuesve që e kanë nënshkruar Kararnamenë: Iljaz Pashë Dibra, Abdullah Pashë Dreni, Sheh Mustafa Tetova, Jashar beu i Shkupit, Shaqir Curri e plot të tjerë. Ndërsa në prapaskenë e përkrah të tyre, madje realisht, në ballë të tyre qëndronte Pashko Vasa, i cili mund të quhet pa asnjë dyshim ideatori i pikëpamjeve të shpalosura në kuvend. Ai është dhe formuluesi i dokumenteve programatike të miratuara nga Lidhja e Prizrenit më 15 dhe 17 qershor.

Këtë program Pashko Vasa ia parashtron me gjuhë diplomatike fuqive pjesëmarrëse në Kongresin e Berlinit në përkujtesën e datës 20 qershor 1878.³ Në të fjala ishte gjithnjë për sanksionimin e kërkesës për autonominë territoriale administrative të Shqipërisë.

Përmbajtja e dokumenteve të 15 dhe 17 qershorit, niveli profesional juridik e diplomatik i formulimit të tyre të bind se përkrah kuvendarëve në Prizren qëndronin personalitete me përvojë administrative, juridike, me një njohje teorike të shkencave të këtyre fushave në përputhje me realitetin osman në anët e Rumelisë, të pasqyruar në disa botime. Midis tyre shquan Pashko Vasa, i cili po qëndronte në kontakt direkt me to. Mund të arrihet me bindje në përfundimin se Vasa efendiu në ato ditë më shumë se këshilltari i valiut të vilajetit të Kosovës ka qenë këshilltari politik dhe juridik i delegatëve të Kuvendit Themelues të Lidhjes Shqiptare.

Akti i Vendimeve (Kararname) dhe Urdhëresa (Talimati) janë formuluar nga specialistë të së drejtës shtetërore dhe islame. Një i tillë dhe ndër më të shquarit midis tyre ishte Pashko Vasa, ish-anëtari i Këshillit të lartë të Drejtësisë të Perandorisë Osmane, autor i disa

³ “populli shqiptar kërkon që, pa i cënuar fare të drejtat e paparashkrueshme të sovranitetit të Madhërisë së Tij Sulltanit, të ngrihet një Komision *ad hoc*, i përbërë nga shqiptarët, i cili në mbikqyerjen dhe me pëlqimin e Portës së Lartë, do të mund ta studiojë formën dhe t’i caktojë rregullat e institucioneve të reja lokale, duke ua përshtatur karakterit, dokeve dhe nevojave të vendit”. *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1878-1912)*, Tiranë, 1978, f. 48-50; Pashko Vasa, *Vepra*, 3, Prishtinë, 1989, 350.

studimeve në këtë fushë që nga e drejta romake e deri te përsiatjet e legjislacionit osman me legjislacionin modern evropian.

Lidhja, për sa i takon karakterit, lindi si organizatë kombëtare që në ditët e para të themelimit të saj, falë angazhimit dhe orientimit të drejtë të atdhetarëve, si Pashko Vasa, të përqendruar në Prizren në fillim të muajit qershor të vitit 1878, të lidhur me përfaqësuesit e të gjitha viseve shqiptare përmes Komitetit të Stambollit dhe të angazhuar për orientimin e drejtë atdhetar të punimeve të Kuvendit, me gjithë mungesën e shumë prej tyre në të ⁴.

Pjesëmarrësit e Kuvendit të mbledhur në Prizren, me orientimin e atdhetarëve, si Pashko Vasa, qysh në ditët e para të tij u bënë interpretë të vullnetit të qarqeve më të përparuara politike shqiptare brenda dhe jashtë Kuvendit. Ata, në të njëjtën kohë, shpalosën qysh më 15 qershor platformën për krijimin e një fronti të përbashkët të mbarë shqiptarëve përballë armiqve të huaj që kërkonin ta gjymtonin tërësinë territoriale të atdheut, kur ende nuk ishin bërë të njohura vendimet e Kongresit të Berlinit për aneksimin edhe të viseve të Jugut nga Greqia. Ky front do të drejtohej, sipas “kushtetutës” së Lidhjes, kundër armiqve të kombit të cilët u mohonin shqiptarëve të drejtat kombëtare. Me vendimet që morën atë ditë kuvendarët e Prizrenit në qershor të vitit 1878 hapën rrugën, hodhën themelet e shëndosha dhe bënë të mundur që ky front të siguronte udhëheqjen e një organizate politike mbarëshqiptare, antiosmane dhe me fizionomi plotësisht kombëtare siç ishte Lidhja Shqiptare. Në radhët e para të tyre qëndronte Pashko Vasa me përfytyrimet e qarta dhe me konceptet e tij shkencore për të ardhmen e atdheut. Ai u bë përfaqësues i elementëve më të përparuar të Komitetit të Stambollit, në Shqipëri ⁵.

Janë pikërisht përfaqësuesit e popullsisë shqiptare të Kosovës pranë të cilëve u ndodhën dhe atdhetarë si Pashko Vasa, ata të cilët kanë qenë nismëtarë të lëvizjes për themelimin dhe orientimin mbi baza tërësisht

⁴ *Akte të Rilindjes ...*, f.65-66.

⁵ Në kundërshtim me këtë realitet, autorë ballkanas, në radhë të parë ata serbe të paraprirë nga Haxhivasiljeviçi e të pasuar deri në ditët tona nga shumë autorë të tjerë deri te D. Bogdanoviçi pretendojnë se përfaqësuesit shqiptarë në Kuvendin e Prizrenit në javët e para të punimeve të tij e në vijim, qenë të përçarë në dy rryma, sipas ndarjes gjeografike e krahinore: në atë të progresistëve të Shqipërisë Jugore e të Mesme dhe në atë të konservativistëve të Shqipërisë Veriore e Verilindore. Pikëpamje të tilla patën zënë vend dhe patën ndikuar gjerësisht midis autorëve tanë deri në ditët e sotme.

kombëtare të Lidhjes së Prizrenit, qysh në hapat e para të saj. Ishin pikërisht këta, të cilët, duke folur në emër të mbarë popullit shqiptar, i dhanë Lidhjes, qysh në fillimet e saj, platformën mbarëshqiptare, programin atdhetar dhe taktikën revolucionare të luftës për ruajtjen e tërësisë së trojeve amtare dhe njëkohësisht, të luftës për sigurimin e të drejtave kombëtare, të paktën deri në shkallën e një autonomie politiko-administrative në kuadër të Perandorisë Osmane. Këtë detyrë ata e kryen, meqë koha nuk i lejonte, siç dëshmojnë aktet e para të Kuvendit të Prizrenit, pa pritur ardhjen e përfaqësuesve të viseve të tjera. Prandaj dhe delegatët e vilajetit të Shkodrës dhe të Manastirit pas tyre dhe ato të vilajetit të Janinës u bashkuan njëri pas tjetrit me besim të plotë rreth nismëtarëve dhe themeluesve të Lidhjes së Prizrenit, kryesisht nga Kosova: Iljaz Pashë Dibra, Sheh Mustafa Tetova etj., së bashku me shkodranin Pashko Vasa në krye duke i dhënë asaj tashmë faktikisht, jo vetëm në letër, karakterin mbarëshqiptar.⁶ Ky proces ka zgjatur afro një muaj, me sa duket deri më 2 korrik të vitit 1878.

Edhe kur Stambolli e largoi nga Kosova në Edrene, në postin e zëvendësvaliut, Vasa efendiu nuk ishte larg teatrit kryesor të veprimeve politike të shqiptarëve në mbrojtje të trojeve amtare dhe të luftës për sigurimin e të drejtave kombëtare. Në vijim të veprimtarisë së tij kulturore, shkencore, atdhetare, njëkohësisht ai tani harton dhe boton traktatin e tij historiko-programatik “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”. Në të ai argumenton dhe shpall para opinionit publik europian, programin autonomist të miratuar në Prizren.

Funksioni i lartë që mbante në administratën osmane nuk e pengoi Pashko Vasën për t’iu përgjigjur detyrave të rëndësishme. Përkundrazi, ai e shfrytëzoi postin qeveritar për t’i shërbyer më mirë çështjes kombëtare në momente vendimtare për fatet e atdheut. Me përvojën e grumbulluar,

⁶ Edhe kur e transferuan nga Kosova, Pashko Vasa vijoi veprimtarinë e tij në dobi të çështjes së sendërtimit të platformës së Lidhjes së Prizrenit, çështjes së tërësisë dhe pavarësisë së Atdheut, propagandimit dhe mbrojtjes së saj në arenën diplomatike, çështjes së zhvillimit të kulturës kombëtare dhe të përparimit të popullit të vet. Vehbi Bala, *Pashko Vasa (portret-monografi)*, Tiranë, 1979, f. 7; Po ai, *Pashko Vasa – shkrimtar i Rilindjes kombëtare*, në: “Pashko Vasa – Luigj Gurakuqi” (Përkujtime), botim i Institutit të Lartë Pedagogjik i Shkodrës, Shkodër 1976, f.64; Po ai, *Pashko Vasa si ideolog i Lidhjes Shqiptare*, në: “Konferenca Kombëtare e studimeve për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878-1881)”, (12-28 qershor 1978), I, Tiranë, 1979, f. 204.

ai u gjend aty ku formuloheshin dhe parashtroheshin këto dokumente programatike.

Me përkujtesat drejtuar forumeve dhe personaliteteve evropiane si dhe me kontaktet e vazhdueshme me diplomatët në Stamboll, Pashko Vasa propagandoi, argumentoi dhe mbrojti platformën e Lidhjes Shqiptare para Fuqive të Mëdha. Këtij synimi i shërbeu në mënyrë të veçantë vepra e tij madhore “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët”, e cila doli, me sa besohet, në fillimet e vitit 1879 në frëngjisht. Me këtë traktat programor ai i dha Lëvizjes Kombëtare Shqiptare manifestin ideologjik që i kishte munguar deri më atëherë. Në të ai formuloi dhe argumentoi historikisht për herë të parë, gjerësisht kërkesën për autonominë administrative të Shqipërisë. Me këtë veper Pashko Vasa luan jo vetëm rolin e nismëtarit, por dhe të themelvënësit të një literature të tërë ideo-politike të Rilindjes, e cila erdhi dhe u zhvillua, duke u ngritur në shkallë të reja dhe më të larta me zhvillimin e mëtejshëm dhe konsolidimin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

Vepra “E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët” përgjithësoi përvojën e deriatëhershme historike të popullit shqiptar për të argumentuar drejtësinë e kërkesave kombëtare të shqiptarëve të paraqitura në mënyrë programatike dhe institucionale nga ana e Lidhjes së Prizrenit.

E botuar në fillim të vitit 1879 vepra madhore e Pashko Vasës është njëkohësisht dhe përgjithësim i përjetimit të Krizës Lindore nga ana e popullit shqiptar. Në mënyrë të veçantë kjo veper është pasqyrë e shkallës së pjekurisë së mendimit politik shoqëror shqiptar të kohës të materializuar në pikëpamjet e shprehura edhe në botime të tjera e veçanërisht në shtypin turk dhe evropian nga bashkëmendimtarët dhe bashkëluftëtarët e Vasës.

Në radhë të parë, vepra e Pashko Vasës përfaqëson argumentimin shkencor historik të drejtësisë së protestave të panumërta të popullsisë shqiptare nga veriu në jug të vendit kundër vendimeve të padrejta të Traktatit të Shën-Stefanit dhe sidomos të Kongresit të Berlinit për copëtimin e trojeve shqiptare. Në të me një gjuhë të përmbledhur dhe diplomatike vihen në emërues të përbashkët protestat kundër copëtimin të trojeve shqiptare, kërkesa e argumentuar historikisht dhe e drejtuar fuqive evropiane për njohjen e kombit shqiptar si dhe kërkesa e drejtuar jo vetëm atyre, por dhe Portës së Lartë dhe sulltanit për krijimin e vilajetit të bashkuar shqiptar. Edhe pse të formuluar në mënyrë tepër konçize ato

mbeten, pavarësisht nga detajimi dhe hollësitat me të cilat u pajisën dokumentet e mëvonshme të Lëvizjes Kombëtare, programi bazë i Lëvizjes Kombëtare shqiptare deri në fund të shekullit XIX.

Për njëzet vjet, deri në vitin 1899 kur doli traktati i Sami Frashërit “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do ë bëhet?”, vepra e Pashko Vasës mbeti platforma kryesore programore dhe propaganduese e Rilindjes sonë Kombëtare. E botuar në disa gjuhë ajo militoi në arenën diplomatike dhe në opinionin europian në dobi të çështjes kombëtare për afro një çerek shekulli.

Pashko Vasa u shqua veçanërisht gjatë viteve të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në përpjekjet për themelimin e saj, për orientimin e drejtë të lëvizjes dhe për argumentimin e synimeve të kësaj organizate si dhe për mbrojtjen e të drejtave kombëtare në arenën evropiane, pra, për ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare. Edhe pse funksionar i lartë i Perandorisë Osmane ai luajti një rol të shquar jo vetëm në formulimin e nevojës së krijimit të Lidhjes së Prizrenit, për çka ai u përpoq të bindte edhe Portën e Lartë dhe sulltanin, por dhe për ndihmesën e dhënë në përpjekjet për sendërtimin e saj brenda vendit. Ai hyri në këtë betejë me një përvojë shumë të pasur, afro 40 vjeçare, të gjithanshme: revolucionare, administrative, politike, diplomatike, letrare, publicistike dhe shkencore.

Me veprën letrare dhe publicistike-historike dhe si hartues i një vargu përkujtesash që i shërbyen drejtpërsëdrejti luftës që po bënte Lidhja e Prizrenit në mbrojtje të çështjes kombëtare, u bë shprehës konsequent i kërkesave dhe pikëpamjeve më të përparuara dhe realiste të lëvizjes patriotike shqiptare në këtë periudhë.⁷

Relativizimi, mund ta quajmë, i rëndësisë së ndihmesës madhore të Pashko Vasës në të gjitha rrafshet: ideor, politik, organizativ, por sidomos në rrafsh ideologjik gjatë viteve të Lidhjes së Prizrenit shprehet

⁷ Trajtimi i personalizuar i viteve 1878-1881 vetëm e vetëm në funksion të ndihmesës së përligjur të figurave të tilla, si: Abdyl Frashëri apo dhe Ymer Prizreni në udhëheqje të Lidhjes Shqiptare, e kanë lënë në hije kontributin e Pashko Vasës në themelimin dhe orientimin e drejtë të Lidhjes së Prizrenit si dhe në propagandimin e synimeve të saj në shkallë ndërkombëtare. Ndërsa figura e ideologut të Lidhjes dhe të mbarë Rilindjes deri në fund të shek. XX është minimizuar kaq shumë sa mund të thuhet se është mënjanuar tërësisht.

dukshëm në trajtesat jo të pakta kushtuar historisë së Lidhjes së Prizrenit, në të cilat ai ose është injoruar ose është kaluar shkarazi.⁸

Veprimtaria dhe kontributi i Pashko Vasës nuk mund të kufizohet vetëm në fushën kulturore. Ato kanë qenë, siç u dëshmuar në trajtimin e dokumentuar të parashtruar më sipër, parësorë në momentet vendimtare të themelimit, organizimit dhe pajisjes së Lidhjes së Prizrenit me programin kombëtar dhe popullarizimin e synimeve të saj në shkallë ndërkombëtare.

Si përfundim, mund të themi se Pashko Vasa ishte ideator, nismëtar, themelues dhe organizator i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ai ishte, njëkohësisht, diplomat i rangut të lartë, propagandues dhe mbrojtës me argumente shkencore i programit të saj, dhe ideologu i parë i madh i Lidhjes dhe, për një çerekshekulli, i mbarë Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.

⁸ Të habit fakti që edhe poeti i “Lahutës së Malësisë”, patër Gjergj Fishta, në epopenë e tij nuk ka as edhe një varg për shkodranin e tij të mirënjohur Pashko Vasa, ndërsa i kushton me të drejtë sa e sa vargje Abdyl Toskës.